

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“SOLAR M&L” sh.p.k.

Në Tiranë, sot me datë 09.01.2023, (nëntë janar, viti dymijë e njezet e tre), ne të nënshkruarar e mëposhtme:

Donika Kola, e bija e Kol dhe e Pashkes e datëlindjes 08.02.1992, lindur në Fushë-Arrëz, Pukë dhe banuese sipas gjendjes civile Spiten Lezhë ne adresen Nd. 14; H. 1; ZEJMEN; SPITEN; 4510; LEZHË, madhore dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, e identifikuar me pasaportën me nr BC1050290 dhe nr ID Nr personal J25908037E,

Brixhilda Filopati, e bija Kozma dhe e Zoicës e datëlindjes 14.06.1981 , lindur ne Kuçovë dhe banuese në Tiranë me adrese KODRA DIELLIT; Nd. 20; H. 6; Ap. 13; FARKË; SELITË; 1044; TIRANË, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, e identifikuar me Leternjoftimin ID Nr personal I15614059H,

*Me cilësinë e “Ortakeve Themelues”, redaktoj këtë akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklarojme se me vullnet të lire të plote e të sinqertë, dhe inisiativen e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, me ndryshimet përkatëse, në ligjin “Për QKB”, në Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojme shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin **“SOLAR M&L” sh.p.k.***

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“SOLAR M&L”** sh.p.k.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria **“SOLAR M&L”** sh.p.k., është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”), e themeluar nga personat fizikë të sipërpërmendur, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në, Tiranë, Lagjia 1 Rruga “Sulejman Delvina” mbas postës nr. 8, kati II.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4

Objekti

Donika Kola
Donika

Brixhilda Filopati
Brixhilda

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“SOLAR M&L” sh.p.k.

Në Tiranë, sot me datë 09.12.2022, (nëntë dhjetor, viti dymijë e njetzet e dy), ne të nënshkruarat e mëposhtme:

Donika Kola, e bija e Kol dhe e Pashkes e datëlindjes 08.02.1992, lindur në Fushë-Arrëz, Pukë dhe banuese sipas gjendjes civile Spiten Lezhë, por rezidente me adresë: Vergelslaan 19, 1700 Dilbeek, Belgique, madhore dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, e identifikuar me pasaportën me nr BC1050290 dhe nr ID Nr personal J25908037E,

Brixhilda Filopati, e bija Kozma dhe e Zoicës e datëlindjes 14.06.1981, lindur në Kuçovë dhe banuese në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, e identifikuar me Leternjoftimin ID Nr personal I15614059H,

*Me cilësinë e “Ortakeve Themelues”, redaktoj këtë akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklarojme se me vullnet të lire të plote e të sigurtë, dhe inisiativen e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, me ndryshimet përkatëse, në ligjin “Për QKB”, në Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojme shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin **“SOLAR M&L” sh.p.k.***

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“SOLAR M&L” sh.p.k.**

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria **“SOLAR M&L” sh.p.k.**, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”), e themeluar nga personat fizikë të sipërpërmendur, e cila fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në, Tiranë, Lagjia 1 Rruga “Sulejman Delvina” mbas postës nr. 8, kati II.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4

Objekti

Donika Kola



Brixhilda Filopati



Aktiviteti në fushën e energjetikes, ndërtimit, transportit.

Ndërtim të impianteve për prodhimin e energjise. Punime elektrike në tension të ulët, të mesem, të lartë.

Dhënien e konsulencës, projektimin, financimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e impianteve të cilat bëjnë të mundur prodhimin dhe shfrytëzimin e energjisë së rinovueshme si ajo diellore dhe e erës.

Sigurimin, transmetimin, shpërndarjen, importimin, eksportimin dhe tregtimin me shumicë ose pakicë brenda dhe jashtë vendit të energjisë elektrike.

Projektim, ndërtim instalim të impianteve të ujit të pijshëm dhe ujrave të zeza, të rrjetit ujesjellës kanalizime dhe energjetikës.

Transport të materialeve të ndryshme dhe mbetjeve (urbane të rrezikshme).

Shitblerje dhe dhenie me qera të makinerive e pajisjeve të punës dhe pasuri te paluajtshme.

Aktivitet në hoteleri turizëm e agrobiznes.

Import – Eksport shitje me shumicë e pakicë, material elektrike, ndërtimi, industrial, hidroteknike, kimikate, karburante e lënde djegese, lubrifikante, pjesë kembimi auto, pajisje teknologjike mjedisore, makineri e pajisje të çdo lloji.

Studim, projektim, konsulencë, raporte, ndërtim në fushat energjetike, mjedis, ujesjellës kanalizime, hidroteknike dhe sektore të tjera të industries.

Supervizim, mbikqyrje punimesh, shfrytezim i vendburimeve minerare të ngurta e të lengëta, përpunim mineralesh, inertesh, hapje puse uji etj

Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimtaritë që rezultojnë të nevojshme ose të dobishme për realizimin e qëllimeve të saj si: veprime me pasuri të paluajtshme, veprime me pasuri të luajtshme, veprime tregtare, industrial dhe financiare, të marrë pjesë në prokurime publike për të marrë përsipër dhënien apo menaxhimin e shërbimeve me interes ekonomik të përgjithshëm ose aktiviteteve të tjera të nevojshme për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj, si edhe çdo veprimtari që është e lidhur me objektin e Shoqërisë.

Shoqëria mund të fitojë pjesëmarrje me të drejta në shoqëri të tjera, konsorciume ose ndërmarrje vendase dhe të huaja, si dhe të themelojë shoqëri të tjera me objekt të ngjashëm, plotësues ose ndihmës, analog ose të lidhur me të saj in ose shoqërive në të cilat zotëron pjesëmarrje të drejtëpërdrejtë ose jo, të çfarëdolloj forme, si edhe t'i menaxhojë këto pjesëmarrje dhe/ ose të drejta, me kusht që ato të mos ndryshojnë thelbin e qëllimeve të Shoqërisë. Gjithashtu, Shoqëria mund të japë garanci reale për detyrime të lidhura me realizimin e veprimtarisë së Shoqërisë, edhe në favor të palëve të treta.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KREU II **KAPITALI**

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është **100.000 (njëqind mijë) lekë** dhe është i përbërë nga **2 kuota**.

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është tërësisht i nënshkruar, i papaguar, ndahet në 2 kuota me vlerë, që përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë, që zotërohet nga Ortaket e shoqërisë te ndarë në dy kuota, si më poshtë:

- 1- Donika Kola**, zotëruesja e 1 kuote, që përbën 50 % të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë, me vlerë të përgjithëshme 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Donika Kola
Donika Kola

Brisinda Fajon
Brinda Fajon

- 2- **Brixhilda Filopati**, zotëruesja e 1 kuote, që përbën 50 % të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë, me vlerë të përgjithëshme 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cënimit.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilësuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

Donika Kola
[Signature]

Brixhilda Filopati
[Signature]

- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e te pakten tri të katërtave të zoteruesve të kapitalit të shoqërisë, që janë pjesëmarrës në mbledhje.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 10

Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator.

Administrator i shoqërisë do të jetë Znj. Brixhilda Filopati e cila do të ushtrojë funksionet në këtë detyrë për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërtëritje.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit do të jenë të pakufizuara dhe çdo ndryshim i tyre njoftohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Administratorët mund të përfaqësojnë shoqërinë së bashku ose veç njëri nga tjetri dhe mund të prokurojnë të tretë për përfaqësim të tyre. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

Donika Kola


Brixhilda Filopati


ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe në rastet kur :

- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe

- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Neni 14

Baza Ligjore

Donika Kola
Ammb

Bishuldo Filopohi
Bishuldo

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16

Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 3 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga ortakët e shoqërisë tregtare, nënshkruan në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tyre orgjinale.

ORTAKET E SHOQËRISË

Donika Kola



Brixhilda Filopati

